



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	21250-00080-11-2020	Data e Regjistrimit	1/13/2020
Numri i Vendimit	11-2020-199	Data e Vendimit	2/16/2020

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Shpëtim Reka

ANËTAR

SEKRETARE Xheni Muka

Objekti: Deklarimi që detyrimi i parashikuar në titullin ekzekutiv vendim i Gjykes Administrative të Shkalles së Pare Tirane nr. 965, date 13.03.2017 është shuar plotësisht me ane të ekzekutimit.

Baza Ligjore : Kodi i Procedures Civile, veçanërisht nenet 609.

Përmbledhja e vendimit:

Gjykata pasi shqyrtoi aktet shkresore që i bashkëngjiten kërkes padise si dhe parashikimeve të nenit 61 të K. Pr. Civile, ka vendosur të marrë në shqyrtim kryesisht kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes dhe

Vëren:

Me datën 10.01.2020 pranë kësaj gjykate është regjistruar për gjykim çështja civile Nr. 21250-00080 (1080) që i përket palës paditëse Shoqëria Tregtare “Durrës Container Terminal” sh.a. me qendër në Durrës, me të paditur Permbarues Gjyqësor Marsel Himallari, me adresë; Rruga Tregtare Durrës dhe me pale të trete Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Tiranë me objektin Deklarimi që detyrimi i parashikuar në titullin ekzekutiv vendim i Gjykes Administrative të Shkalles së Pare Tirane nr. 965, date 13.03.2017 është shuar plotësisht me ane të ekzekutimit

Rezultoni nga aktet e çështjes se: Pala paditëse Shoqëria Tregtare “DURRËS CONTAINER TERMINAL” sh.a. (Terminali i Kontejnerëve Durrës sh.a.) me qendër në Durrës, është një person juridik tregtar i së drejtës shqiptare, me formë ligjore të organizimit shoqëri aksionare. Kjo shoqëri është themeluar me datë 21/09/2011 dhe është regjistruar me datë 26/09/2011 në regjistrin tregtar si dhe në organet tatimore duke u pajisur me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) L12126504E. Selia e shoqërisë ndodhet në Durrës, me adresë: Durrës, Porti Detar Durrës. Përfaqësues ligjor i shoqërisë (administrator) është shtetasja Ada Kollçaku. Objekti i aktivitetit tregtar të shoqërisë është: “Aktivitetit i kësaj shoqërie koncensionare është në përputhje dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 532, datë 13/07/2011 “Për miratimin e Kontratës së Koncesionit”. Për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të Terminalit të kontejnerëve në portin e Durrësit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Durrës Kurum Shipping” sh.a. dhe “Global Ports Holding” sh.a, që do të thotë menaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik dhe adaptimim për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut të Terminalit të Kontejnerëve në Portin e Durrësit, duke përfshirë ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve kontinerike dhe aktivitete të lidhura të tilla si depozitim i kontejnerësh, magazinim, lëvizje ekstra, transportim, spostim, marrjen dhe shpërndarjen dhe përfshirë marrjen e masave të burimeve të kërkuara për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

mjete, pajisje, sisteme, praktika, procedura, programe, organizim dhe burime njerëzore në përputhje me praktikat më të mira industriale siç janë të specifikuara në Termat e Referencës”. Statusi i shoqërisë në momentin e zhvillimit të këtij gjykimi është “aktiv”. Sa më lart rezulton e provuar me ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e kësaj shoqërie lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me datë 12/06/2019.

Personi i tretë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës më datë 22/06/2011 ka lidhur kontratën e koncesionit për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e terminalit të kontenierëve në portin e Durrësit, me bashkimin e përkohshëm të shoqërive “Durrës Kurum Shipping” Sh.a, “Mariner” S.a. dhe “Global Liman Islemtleeri” A.S. Pas lidhjes së kontratës këto shoqëri kanë themeluar shoqërinë koncesionare, “Durrës Container Terminal” Sh.a., të cilës i kanë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me kontratën koncesionare dhe ekzekutimin e saj. Kjo kontrate është miratuar me VKM Nr. 532 datë 13/07/2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 121, datë 25/08/2011. Me VKM Nr. 665, datë 26/09/2012 është bërë miratimi i një ndryshimi në Kontratën e Koncesioneve, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 136, datë 18/10/2012. Me anë të protokollit të dorëzimit Nr. 456, datë 06/02/2013 është bërë dorëzimi i Terminalit të Kontenierëve në Portin e Durrësit. Sipas pikës 2.4.1, Nenit 2.4. “Periudha Koncesionare”; “... Koncesioni sipas kësaj Kontrate jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vitesh (“Periudha Koncesionare”) e cila fillon nga data efektive. Sipas “Përkufizimet dhe Interpretimet; paragrafit (x) të pikës 2.5.1, të nenit 2.5 “Deklarime dhe garanci të Palëve”; “Data e fillimit të operimit do të thotë data në të cilën koncesionari fillon operimin në Terminalin e Kontenierëve Durrës jo më vonë se gjashtë muaj nga Data Efektive. Ish Ministria e Punëve Publike dhe Transportit sot Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në zbatim të nenit 6 të kontratës me Urdhër Nr. 82, datë 29/08/2011 ngriti dhe strukturën e Njësinë e Zbatimit të Prokurimit si strukturë administrative e ngarkuar në mënyrë ekskluzive për ndjekjen, zbatimin e kushteve dhe përgjegjësi kontraktuale të Autoritetit Kontraktor Në zbatim dhe ndjekje të vazhdueshme të kontratës koncesionare “Për dhënien me koncesion të terminalit të kontenierëve në Portin e Durrësit”, nga ana e palës paditëse Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës janë konstatuar shumë probleme dhe mospërmbushje gjatë ekzekutimit të kontratës.

Në kushtet e mospërmbushjes së kësaj kontrate Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Tiranë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar “Zgjidhjen e kontratës “Për dhënien me koncesion të menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit teknik të terminalit të kontenierëve në portin e Durrësit” datë 22/06/2011, për shkak të mospërmbushjes nga ana e koncesionarit të detyrimeve që lindin nga kjo kontratë koncesionare”. Rezulton se me vendimin Nr. 80-2017-998 (965), datë 13/03/2017 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: - Pranimin e kërkesë padisë.

- Zgjidhjen e kontratës se koncesionit Për dhënien me koncesion të menaxhimit operimit mirëmbajtjes dhe përmirësimit teknik të terminalit të kontenierëve në portin e Durrësit datë 22.06.2011.

- Pushimin e gjykimit për pjesën tjetër të saj.

- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Vendimin Nr. 86-2019-395 (370), datë 12/02/2019 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 965 (80-2017-998), datë 13/03/2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë.

- Kundër vendimit mund të ushtrohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Tiranë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të tij.

Pas vendimit të mesiperm, pala e tretë Ministria Infrastruktura dhe Energji me shkresën me Nr. 5670 prot. datë 06/06/2019 ka njoftuar palen paditese "Njoftim për zgjidhjen e kontratës dhe fillimin e procedurës për transferimin e asetëve dhe të drejtave objekt i kontratës koncesionare",

Me pas, pales paditese i është njoftuar shkresa me nr.05/1145 date 21.11.2019 "Lajmerim për ekzekutim vullnetar" për zbatimin e vendimit Gjykatës Administrative të shkallës parë lene në fuqi me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata pasi u njoh me aktet dhe pretendimet e palës paditese nëpërmjet kërkesë paditese dhe akteve bashkëlidhur konstaton se kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje në themel të së cilës qëndrojnë parashikimet për procedurat e lidhjes së kontratave administrative dhe për lidhjen e saj palët kontraktore kanë vepruar sipas rregullave për kontratën koncesionare e cila është kontratë administrative.

Në rastin në gjykim Gjykata vlerëson se duke qenë se njëra nga palët është "shtet" (Ministria e Industrisë dhe Energjisë) dhe aplikohet një ligj specifik që i jep kontratës natyrën e kontratës administrative, kompetenca lëndore i takon gjykatës administrative. Në nenin 4 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" gjejmë përkufizimin e kontratës administrative si vijon:

4. "Kontrata administrative" është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik.

Referuar sa më lart edhe kontrata objekt gjykimi vlerësohet se është një kontratë administrative për pasojë mosmarrëveshjet që lidhen me vlefshmërinë dhe zbatimin e saj si dhe zgjidhjen e pasojave të lindura për shkak të saj, i përkasin gjykatës administrative.

Rezulton se në momentin aktual të ndarjes së çështjes me short për gjykimin e saj, janë vërtetuar dy fakte, të cilat referuar edhe parashikimit të nenit 61 të K. Pr. Civile, bëjnë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës të mos ketë më kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes dhe kështu bëjnë të domosdoshme dërgimin e saj gjykatës kompetente që është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Rezulton se me datën 04/11/2013 ka filluar funksionimi i gjykatave administrative referuar Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", dhe Dekretit të Presidentit të Republikës 8349, datë 14/10/2013 për fillimin e funksionimit të këtyre gjykatave. Vetë ligji, i cili rezulton se është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 53, të vitit 2012 ka hyrë në fuqi me datën 30/05/2012, 15 ditë pas botimit të tij. Dekreti i Presidentit të Republikës referuar nenit 70 të ligjit përkatës ka përcaktuar datën kur ka filluar funksionimi i këtyre gjykatave.

Në lidhje me kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjeve administrative, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën gjyqësore me vendimin unifikues Nr. 3, datë 06/12/2013. Me këtë vendim është mbajtur qëndrimi se:

Së pari: Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, gjykatat civile nuk mund të zgjidhin më mosmarrëveshje administrative, për shkak se kompetenca lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative i ka kaluar gjykatave të krijuara për zgjidhjen e tyre me ligjin e posaçëm nr. 49/2012.

Së dyti: Me fillimin e zbatimit të ligjit të posaçëm, pra me datë 04.11.2013, të gjitha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Civile, ku mbështetet vendimmarrja e gjykatave në zgjidhjen e çështjeve administrative u shfuqizuan. Për këtë arsye, gjykatat civile nuk kanë bazë ligjore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Së treti: Ligji nr. 49/2012 parashikon jo vetëm krijimin e gjykatës së posaçme për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative por edhe parime të ndryshme procedurale mbi bazën e të cilave do të zgjidhen këto mosmarrëveshje. Për këtë arsye, ligji i ri duhet të gjejë zbatim sa më parë për të arritur qëllimin për të cilin ai është miratuar, pra efikasitetin dhe efektivitetin e gjykimit administrativ.

Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në interpretimin unifikues se:

Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr.49, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit."

Referuar parashikimeve të nenit 7 të Ligjit Nr. 49/2012 rezulton se në kompetencë lëndore të shqyrtimit të gjykatave administrative janë ndër të tjera edhe kontratat administrative publike (neni 7, germa "a" e ligjit).

Në rastin në gjykim jemi para një kontrate administrative e cila është zgjidhur me një vendim të formës së prerë nga gjykata administrative për të cilën palët kanë pretendime për pasojat e zgjidhjes së kësaj kontrate.

Rezulton se kjo gjykatë një qëndrim të tillë ka mbajtur (për shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes për gjykim në gjykatën administrative) edhe në çështjen civile nr. 21234-00683 (1110) datë 01/03/2016 me palë paditëse Shoqëria Tregtare "ARBLEV" sh.p.k. dhe Shoqëria Tregtare "Start &Co" sh.p.k. me të paditur Autoriteti Portual Durrës, e cila paraqet një natyrë të ngjashme të mosmarrëveshjes.

Për këtë çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur të ngrejë çështje në lidhje me mosmarrëveshjen për kompetencën lëndore dhe rezulton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 00-2016-2560, datë 13/07/2016 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 11-2016-1167 (363), datë 08/03/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në atë vendim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se:

11. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, shkaqet që ngrihen nga Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Durrës në lidhje me mosmarrëveshjen për kompetencën lëndore ndërmjet gjykatave të shkallës së parë nuk janë të bazuara në ligj, prandaj vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk është i cënueshëm.

12. Arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës se: ... Referuar parashikimeve të nenit 7 të ligjit nr. 49/2012 rezulton se, në kompetencën lëndore të shqyrtimit të gjykatave administrative janë ndër të tjera edhe kontratat administrative publike (neni 7, germa "a" e ligjit). Ndërsa neni 17 germa "f" e ligjit të më mësipërm parashikon se, padia në gjykatën administrative mund të ngrihet me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor sipas ligjit të posaçëm. Në rastin në gjykim jemi përpara një kontrate administrative për të cilën palët kanë pretendime dhe ku është përfshirë në mosmarrëveshje edhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP). Konflikti ka në themel veprimet dhe mosveprimet e Autoritetit Portual Durrës nëpërmjet një procedure të qartë dhe të përcaktuar hollësisht në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Po ashtu organizimi dhe funksionimi i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Autoritetit Portual Durrës (sikundër i autoriteteve portuale të tjera që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë) rezulton që të jetë rregulluar nga një ligj organik, që është ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” dhe në këtë vështrim ky subjekt nuk është një shoqëri tregtare tradicionale, por një subjekt me një natyrë të posaçme.... është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi në rastin konkret palë e paditur, është një organ i administratës publike, i cili kryen veprimtari publike dhe në zbatim të ligjit nr. 49/2012 kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga veprimet apo mosveprimet e një organi të administratës publike janë gjykatat administrative.

13. Në nenin 17 pika 1 germa “ç” të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikohet se: Padia ngrihet: ...ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, ky Kolegj organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, ky Kolegj vlerëson se, kompetenca lëndore për gjykimin e kësaj çështje i përket Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, sepse pala paditëse në kërkimin e saj kërkon detyrimin e palës së paditur Autoriteti Portual Durrës që të dëmshpërblejë dëmin e rrjedhur nga një kontratë administrative dhe për rrjedhojë në bazë të nenit 17/ç të ligjit nr. 49/2012 kjo padi i përket sferës së të drejtës publike (administrative).

14. Duhet theksuar se, dëmi i pretenduar nga pala paditëse ka ardhur si pasojë e veprimeve të palës së paditur, Autoritetit Portual Durrës, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij në cilësinë e një organi që kryen funksione publike në procedurat e prokurimeve publike, prandaj Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka arritur në konkluzione të pabazuara në ligj, kur shprehet se, kemi të bëjmë me një kthim shume, e cila është pasojë e një procedure të prokurimit publik. Duke iu referuar dhe përmbajtjes së nenit 13 pika 5, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, çështja duhet të shqyrtohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, e cila është gjykata kompetente nga pikëpamja e lëndës së shqyrtimit, prandaj vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, duhet të lihet në fuqi.

Në rrethanat e mësipërme, në vështrim të parashikimeve ligjore dhe praktikës gjyqësore vlerësohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes. Për pasojë gjykata duhet të vendosë të shpallë moskompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes dhe t'i dërgojë aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës që është gjykata kompetente për shqyrtimin e saj.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Në bazë të neneve 42, 59, 61, 62 të K. Pr. Civile ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative” dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 3, datë 06/12/2013, .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Vendosi:

Te shpalle moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes civile nr. (21250-00080) 1080 date 13.01.2020 që i perket palës paditëse Shoqëria "Durrës Container Terminal" sh.a me te paditur Përmbarues gjyqësor Marsel Himallari, person i tretë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Tiranë dhe objekt; Deklarimi që detyrimi i parashikuar në titullin ekzekutiv vendim i Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tirane nr. 965, date 13.03.2017 është shuar plotësisht me ane të ekzekutimit.

Dërgimin e kërkesë padisë dhe akteve bashkëngjitur, për kompetencë gjyqësore, Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Durrës.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë, brenda 5 ditëve duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Durrës, më 17.01.2020

Ky dokument është marrë nga www.gjkata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.